

V E N D I M
Nr.12, datë 21.9.1995

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Rustem Gjata, Kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Hilmi Dakli,	Anëtar	i	“““
Manol Konomi,	Anëtar	i	“““
Zija Vuci,	Anëtar	i	“““
Franc Jakova,	Anëtar	i	“““
Alfred Karamuço,	Anëtar	i	“““
Metush Saraçi,	Anëtar	i	“““

me sekretare Drita Filto, më datat 14.9.1995 dhe 21.9.1995, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.14 Akti, që i përket:

K Ë R K U E S: KESHILLI I MINISTRAVE, i përfaqësuar nga Ministrii Drejtësisë Hektor Frashëri.

PERSON I INTERESUAR: ZEF BROZI, Kryetar i Gjykatës së Kasacionit, në mungesë.

O B J E K T I:

1. Këshilli i Ministrave në kërkesën e vet datë 1.9.1995 ka kërkuar deklarimin e veprimtarisë së kryetarit të Gjykatës së Kasacionit si veprimtari të kundraligjshme dhe antikushtetuese në fazën e ekzekutimit të vendimeve civile të gjykatave, duke iu shkaktuar pasoja të rënda të drejtave dhe interesave të qytetarëve dhe atyre shtetërore, veprimtari kjo që konsiston në këto drejtime:

- Në urdhërimet e kundërligjshme drejtuar gjykatave dhe zyrave të përmbarimit për pezullimin e ekzekutimit të vendimeve të formës së prerë të gjykatës;

- Në lëshimin e një udhëzimi për gjykatat dhe zyrat e përmbarimit për mosëkzekutimin e vendimeve kur ato ankimohen pas vendimit të Gjykatës së Apelit në Gjykatën e Kasacionit.

2. Kryetari i Gjykatës së Kasacionit, Zef Brozi, në kërkimet e tij me shkresat e datave 4.9.1995 dhe 13.9.1995, ka parashtruar :

- Shpalljen e mungesës së legjitimitetit të Këshillit të Ministrave për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për çështjen e deklarimit si antikushtetuese të urdhërave e veprimeve të Kryetarit të Gjykatës së Kasacionit;

- Nxjerrjen e kërkesës së Këshillit të Ministrave jashtë juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese;

- Rrëzimin e kërkesës së Këshillit të Ministrave si antikushtetuese, në kundërshtim me parimet e normat ndërkombëtare, si dhe në kundërshtim me faktet reale.

GJYKATA KUSHTETUESE pasi dëgjoji relacionin përkatës,

V Ë R E N:

Gjykata Kushtetuese, para se të hyjë në shqyrtimin e pretendimeve dhe prapësimeve të palëve, e çmon të nevojshme të verë në dukje dy çështje me rëndësi juridike.

1. Kryetari i Gjykatës së Kasacionit ka shfaqur, në mënyrë të përsëritur, pikëpamjen se Gjykata Kushtetuese është një “institucion antikushtetues” duke i mohuar asaj legjitimitetin e çdo juridiksioni. Kryetari i Gjykatës së Kasacionit ka kërkuar të vihet edhe e ka vënë veten mbi ligjin kushtetues, që e ka krijuar këtë Gjykatë dhe i cili përcakton qartë statusin dhe pozitën e saj si “autoriteti më i lartë që mbron dhe garanton respektimin e kushtetutës”. Ky ligj kushtetues cakton gjithashtu përbërjen dhe kompetencat e Gjykatës Kushtetuese, fuqinë ligjore të vendimeve të saj etj. Kryetari i Gjykatës së Kasacionit mbron tezën se të gjitha vendimet që janë dhënë nga kjo Gjykatë janë të kundërligjshme, pavarësisht se ato janë pranuar dhe zbatuar nga të gjitha organet shtetërore dhe nga vetë organi ligjvënës.

Qëndrimi i Kryetarit të Gjykatës së Kasacionit është kontradiktor dhe larg çdo logjike. Ai, nga njëra anë, deklaron se Gjykata Kushtetuese është “antikushtetuese”, e zhveshur nga çdo juridiksion

dhe nuk pranon të paraqitet përpara saj, nga ana tjetër, nuk ndalet në pikëpamjen e tij, por i dërgon kësaj Gjykate para dhe gjatë shqyrtimit të çështjes, shkresa të shumta, me anën e të cilave parashtron prapësimet dhe pretendimet e tij.

2. Kryetari i Gjykatës së Kasacionit, në kundërshtim të hapur me çdo parim e normë procedurale, organizon “takim ballafaqimi” me qytetarët dhe subjektet shtetërore, me qëllim që të provojë të kundërtën e asaj që pretendon pala kundërshtare, Këshilli i Ministrave, në një kohë që çështja është në shqyrtim në këtë Gjykatë.

Kryetari i Gjykatës së Kasacionit, duke shkelur kështu çdo rregull, kërkon të verë Gjykatën para “faktit të kryer”, synon të verë ballë për ballë vendimin, eventualisht negativ, të kësaj Gjykate me përfundimin e arritur në takimin e ballafaqimit.

Prapësimet e parashtruara nga Kryetari i Gjykatës së Kasacionit lidhur me legjitimitimin e Këshillit të Ministrave dhe juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, janë të pabazuara.

Në nenin 25 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, janë përcaktuar edhe subjektet që kanë të drejtë të venë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Një nga këto subjekte është edhe Këshilli i Ministrave. Pretendimi se Këshilli i Ministrave nuk legjitimohet të vërë në lëvizje këtë Gjykatë për të shqyrtuar “kërkesa në emër të shtetasve”, pasi në nenin 24 të ligjit të sipërm kushtetues nuk parashikohet kjo e drejtë, nuk ka bazë. Në këtë normë nuk është vendosur asnjë lloj kufizimi ose specifikimi për Këshillin e ministrave si subjekt që mund të ushtrojë kërkesë, siç është vepruar në pikën 9 për personat fizikë dhe juridikë. Pa një kufizim të shprehur ose që del nga vetë përmbajtja e normës juridike, nuk mund të arrihet në përfundim se ky subjekt nuk legjitimohet të ushtrojë kërkesën objekt gjykimi. As në dispozitat e ligjeve të tjera kushtetuese nuk është vendosur ndonjë kufizim i tillë.

Legjitimimi i Këshillit të Ministrave bazohet edhe në nenin 36 të ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, ku një nga detyrat kryesore të tij është ruajtja e forcimi i rendit juridik dhe mbrojtja e të drejtave të qytetarëve.

Pretendimi se çështja nuk hyn në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese pa kaluar në juridiksionin e zakonshëm gjyqësor, po ashtu është i pabazuar. Nga përmbajtja e normave të ligjit Kushtetues “Për Gjykatën Kushtetuese” dhe nga praktika e kësaj Gjykate, del se, sipas rastit, mund të gjykohej çështja drejtpërdrejt, pa kaluar më parë në hallkat e juridiksionit gjyqësor apo administrativ ose si instancë e fundit. Në rastin konkret kemi të bëjmë me akte individuale urdhëruese të lëshuara në bazë të nenit 185 të Kodit të Procedurës Civile, nga Kryetari i Gjykatës së Kasacionit, dhe me një udhëzim (qarkore) të këtij organi. Këto akte nuk hyjnë në kategorinë e akteve civile apo penale që të mund të kundërshtohen në rrugën e zakonshme gjyqësore. Ligjshmëria e urdhërit të Kryetarit të Gjykatës së Kasacionit për pezullimin e vendimit të formës së prerë të gjykatës, të lëshuar në bazë të nenit 185 të kodit të përmendur, nuk mund të vihet në diskutim nga përmbartuesi apo gjykata. Sipas kësaj dispozite Kryetari i Gjykatës së Kasacionit dhe Prokurori i Përgjithshëm kanë të drejtë të pakushtëzuar të urdhërojnë pezullimin e ekzekutimit të vendimit të formës së prerë, por deri në dy muaj.

Kundër urdhërit të pezullimit të lëshuar në bazë të nenit 185 nuk mund të ushtrohet ankim në gjykatë qoftë në formën e kundërshtimeve përmbartimore qoftë drejtpërdrejt kundër vetë urdhërit. Urdhëri i pezullimit të ekzekutimit të vendimit të formës së prerë, është një nga mjetet legale të Kryetarit të Gjykatës së Kasacionit dhe Prokurorit të Përgjithshëm, të parashikuara në Kreun “Kontrolli i vendimeve të formës së prerë”, i cili nuk mund të atakohet për shkakun e nxjerrjes së tij.

Në këto rrethana Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se çështja është në juridiksionin e drejtpërdrejtë të saj, pasi as gjykatat e sistemit gjyqësor dhe asnjë organ tjetër nuk e ka në kompetencë të vlerësojë ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë e këtyre akteve të kryetarit të Gjykatës së Kasacionit. Gjykata Kushtetuese është ajo instancë që ka të drejtë të shqyrtojë shkeljet e pretenduara nga Këshilli i Ministrave.

Në kërkesën e Këshillit të Ministrave janë parashtruar një sërë rastesh të urdhërave të Kryetarit të Gjykatës së Kasacionit për pezullimin e vendimit të formës së prerë të gjykatës së rrethit të Tiranës, Durrësit, Lushnjes, Lezhës, etj., që i konsideron të kundërligjshëm, për shkak se janë lëshuar për të njëjtin vendim më shumë se një herë, se çështjet janë mbajtur të pezulluara për periudha të gjata kohe dhe se ka patur raste që është urdhëruar edhe pezullimi i vendimit të Plenumit të Gjykatës së Kasacionit, duke shkaktuar zvarritjen e ekzekutimit të vendimeve.

Lidhur me kërkesën e Këshillit të Ministrave, Kryetari i Gjykatës së Kasacionit ka parashtruar

se sipas nenit 185 të Kodit të Procedurës Civile nuk përcaktohet se sa herë mund të urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të vendimit gjyqësor, për rrjedhojë nuk ka pengesë ligjore që ekzekutimi i një vendimi gjyqësor të pezullohet edhe më shumë se një herë; se ligji nuk ndalon pezullimin e ekzekutimit të një vendimi të Plenumit të Gjykatës së Kasacionit.

Për të arritur në një përfundim të saktë lidhur me faktet dhe rrethanat e pretenduara, krahas administrimit në gjyq të urdhërave të pezullimit të ekzekutimit të vendimeve dhe dokumenteve të tjera, Gjykata e çmoi të nevojshme thirrjen e përgjegjësve të zyrave të përbarimit, për të marrë shpjegimet e nevojshme.

Nga këto prova është vërtetuar se Kryetari i Gjykatës së Kasacionit ka nxjerrë urdhëra pezullimi në mënyrë të parregullt pa tërhequr dosjen përkatëse e pa bërë asnjë lloj verifikimi. Në një sëri rastesh ka nxjerrë urdhëra të tilla pezullimi edhe në kundërshtim flagrant me nenin 185. Kundërligjshmëria dhe parregullsia e këtyre lloj urdhërave evidentohet në këto drejtime kryesore : në përsëritjen e urdhërave dy e tre herë si në intervale të shkurtëra ashtu edhe në intervale të gjata kohore, për të njëjtin vendim gjyqësor të formës së prerë; në nxjerrjen e urdhërave për pezullimin e ekzekutimit edhe pas vendimit të Plenumit të Gjykatës së Kasacionit.

Gjykata Kushtetuese kufizohet të përmendë disa prej rasteve të urdhërave të kundërligjshëm.

Kështu në çështjen me nr.788, datë 18.6.1993 të zyrës së përbarimit Tiranë, ndonëse ishte hequr më përpara pezullimi i ekzekutimit të vendimit, Kryetari i Gjykatës së Kasacionit, më datë 23.9.1994 urdhëron pezullimin e ekzekutimit të vendimit. Ky urdhër është i kundërligjshëm, sepse lëshohet për herë të dytë. Nga përmbajtja e tij del se është edhe i parregullt e i lëshuar pa përgjegjësi. Në të thuhet të pezullohet vendimi nr.3788, datë 21.11.1992. Ky vendim i gjykatës së rrethit nuk ishte në ekzekutim, pasi ishte vendosur rrëzimi i padisë. Gjykata e Apelit Tiranë, duke e gjykuar çështjen në fakt, me vendimin nr.1239, datë 26.12.1992, ka vendosur ndryshimin e vendimit të sipërm të gjykatës së rrethit, duke pranuar padinë dhe duke urdhëruar kryerjen e veprimeve të caktuara. Zyra e përbarimit qysh atëhere ka patur në ekzekutim këtë vendim gjyqësor.

Me vendimin nr.474, datë 10.6.1993 të Plenumit të Gjykatës së Kasacionit, që u përket palëve P.S.; S.N. dhe Ndërmarrja Banesa nr.2 Tiranë, janë lënë në fuqi vendimet e gjykatave të tri shkallëve. Pas kësaj është ngritur padi edhe nga Prokuroria e Rrethit të Tiranës me të njëjtin shkak e objekt dhe me të njëjtët subjekte si palë ndërgjyqëse. Gjykata e Apelit të Tiranës në shkallë të dytë, me vendimin nr.385, datë 8.4.1994 ka vendosur përsëri rrëzimin e padisë. Edhe pse ndodhej para këtyre fakteve kryetari i Gjykatës së Kasacionit brenda një afati kohor prej dhjetë muajsh, urdhëron tre herë pezullimin e vendimit nr.385, datë 8.4.1994 (me urdhërat datë 24.5.1994, datë 12.10.1994 dhe datë 28.3.1995).

Për këto urdhëra të përsëritura pezullimi, me datë 8.5.1995 i është ankuar Kryetarit të Gjykatës së Kasacionit edhe qytetari P.S., duke theksuar ndër të tjera se pezullimet i konsideron shkelje të ligjit, që ia cënojnë rëndë të drejtat si qytetar, duke e paralajmëruar se po të mos hiqen do t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese.

Në vendimin me palë T.T. e P.I., Kryetari i Gjykatës së Kasacionit, ka lëshuar dy urdhëra pezullimi, të parin me datë 4.4.1994 dhe të dytin me datë 26.8.1994. Po ashtu ka urdhëruar pezullimin e vendimit të gjykatës nr.3006, datë 10.6.1994 brenda dy muajve e gjysëm dy herë, i pari me datë 9.8.1994 dhe i dyti me 24.10.1994. Të ngjashme janë edhe çështjet me urdhëra pezullimi nr.E - 162, datë 31.10.1994 dhe nr.E - 162/2, datë 11.4.1995; çështja me urdhëra pezullimi nr.13 - 24, datë 14.2.1994 dhe nr.13 - 24/II, datë 23.3.1994, etj.

Urdhëra të përsëritura pezullimi të të njëjtit vendim gjyqësor, Kryetari i Gjykatës së Kasacionit i ka bërë edhe gjykatave e zyrave të përbarimit të rretheve Durrës, Lushnje, Lezhë, etj., madje në ndonjë rast edhe pas ekzekutimit të plotë të vendimit.

Nga shqyrtimi i akteve ka rezultuar se Kryetari i Gjykatës së Kasacionit i është kundërvënë hapur edhe vetë vendimit të Plenumit të Gjykatës së Kasacionit. Kështu, Plenumi i kësaj Gjykate, me Vendimin datë 19.8.1993 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.655, datë 11.6.1993 të Kolegjit Civil. Përsëri Kryetari i Gjykatës së Kasacionit në kundërshtim me ligjin ka ushtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër vendimit të Plenumit. Për shkak të kërkesës ky plenum është mbledhur për herë të dytë për të njëjtën çështje dhe me vendimin datë 30.3.1994 ka vendosur mosshqyrtimin e saj.

Mirëpo, Kryetari i Gjykatës së Kasacionit, duke mos përfillur as këtë qëndrim të Plenumit të Gjykatës, me shkresën nr.45, datë 11.4.1995, njofton Gjykatën dhe zyrën e përbarimit Tiranë, të

veprojë në kundërshtim me vendimin e Gjykatës së Kasacionit. Ndërsa me këtë vendim (Nr.655, datë 11.6.1993) të ligjëruar edhe nga Plenumi urdhërohet detyrimi i N.S. të lirojë banesën në mënyrë të pakushtëzuar, dmth., menjëherë, Kryetari i Gjykatës së Kasacionit, me shkresën e tij vepron në kah të kundërt, duke urdhëruar që zbatimi i vendimit të bëhet sipas kërkesave të ligjit nr.7652, datë 23.12.1993, dmth., në mënyrë të kushtëzuar, pasi sipas tij banesa që duhet të lirohet është banesë refugjati.

Kryetari i Gjykatës së Kasacionit me urdhërat e tij të kundërligjshëm dhe me veprimet e tjera të parregullta i ka çorientuar zyrat e përmbarimit në ekzekutimin e vendimeve. Ndërsa ai vetë urdhëronte edhe disa herë pezullimin e të njëjtit vendim gjyqësor, për ndonjë rast e urdhëronte këtë zyrë po në mënyrë të kundërligjshme të ekzekutonte një vendim të pezulluar në përputhje me kërkesat e ligjit. Kështu, nga shpjegimet e përgjegjësit të zyrës së përmbarimit Tiranë dhe nga aktet e paraqitura prej tij, rezulton se Prokurori i Përgjithshëm me shkresën nr.1575/1, datë 1.12.1993 kishte urdhëruar pezullimin e vendimit të gjykatës nr.3751, datë 8.10.1993. Kryetari i Gjykatës së Kasacionit më datën 4.12.1993 urdhëron të kundërtën me këtë anëshkrim : “Të ekzekutohet vendimi. Në rast të kundërt Përgjegjësi i Zyrës së Përmbarimit do të jepet për ndjekje penale. Pezullimi nga Prokurori i Përgjithshëm nuk është i drejtë. Jepini fund dallaveve në drejtësi.Kryetari i Gjykatës së Kasacionit, Zef Brozi”.

Për më tepër vetë Kryetari i Gjykatës së Kasacionit më vonë ka lëshuar urdhëra për pezullimin të po këtij vendimi.

Pretendimi i Kryetarit të Gjykatës së Kasacionit se neni 185 i Kodit të Procedurës Civile, nuk përcakton se sa herë mund të urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të një vendimi gjyqësor, por përcakton vetëm afatin dy mujor dhe për rrjedhojë nuk ka pengesë ligjore që ekzekutimi i një vendimi të pezullohet edhe më shumë se një herë, është i pabazuar në ligj. Neni 185 i Kodit të Procedurës Civile është i qartë. Sipas këtij neni, pezullimi i vendimit lejohet deri në dy muaj dhe vetëm një herë. Kryetari i Gjykatës së Kasacionit nuk ka asnjë të drejtë të veprojë në kundërshtim me përmbytjen dhe qëllimin e kësaj dispozite.

Po të pranohej arsyetimi i Kryetarit të Gjykatës së Kasacionit, duhet të pranoheshin edhe pasojat e dëmshme që vijnë ose që mund të vijnë prej një qëndrimi të tillë. Njohja e së drejtës Kryetarit të urdhërojë pezullimin në mënyrë të përsëritur e të njëjtit vendim të formës së prerë shkakton mosrealizimin e një të drejte të fituar. Qëllimi i nenit 185 është që nëpërmjet kontrollit të veçantë të vendimeve të formës së prerë, kur është rasti, për të parandaluar pasoja të dëmshme që mund të vijnë nga ekzekutimi i një vendimi të formës së prerë, për bazueshmërinë e të cilit ka dyshime serioze, të jepet mundësia e pezullimit të ekzekutimit, por gjithnjë vetëm deri në dy muaj.

Ky kuptim i nenit 185 është në pajtim me parimin e sanksionuar në nenet 38 e 40 të Ligjit Kushtetues “Për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut”, që garantojnë ndër të tjera një proces të rregullt ligjor dhe një gjykim të shpejtë. Edhe në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut për gjykatat janë parashikuar kriteret e “afatit të arsyeshëm” të procesit gjyqësor e të “parashikimit në ligj”. Argumente të tilla si mangësitë administrative, të ngritura nga Kryetari i Gjykatës së Kasacionit për të justifikuar përsëritjen urdhërave të pezullimit, janë krejt pa vend.

Pretendimi i Këshillit të Ministrave për kundërligjshmërinë e udhëzimit datë 31.12.1993 me titull “Disa probleme për funksionimin e drejtë të veprimtarisë gjyqësore”, të Kryetarit të Gjykatës së Kasacionit, që urdhëron mosekzekutimin e vendimeve të Gjykatës së Apelit kur ato ankimohen në Gjykatën e Kasacionit, nuk qëndron.

Ky akt, që sipas kërkesës është quajtur udhëzim, është nxjerrë nga vetë Gjykata e Kasacionit si shkalla më e lartë e sistemit gjyqësor. Në këto kushte Gjykata nuk mund të marrë në shqyrtim ligjshmërinë dhe bazueshmërisë e një akti të organit që nuk është pjesëmarrës në proces.

Përfundimisht, Gjykata Kushtetuese arrin në konkluzion se Kryetari i Gjykatës së Kasacionit, ka tejkaluar kufijtë e kompetencave që i janë caktuar me ligj, në fazën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore civile, duke cënuar kështu të drejtat themelore të qytetarëve, të garantuara me nenet 38 e 40 të ligjit “Për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut”.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 24, pika 3 dhe pika 10 dhe nenit 25 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë

29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Të shpallë antiligjore dhe antikushtetuese nxjerrjen e urdhërave të përsëritur për pezullimin e të njëjtit vendim civil të formës së prerë të Gjykatës, nga ana e Kryetarit të Gjykatës së Kasacionit, si dhe të pezullimit dhe kundërshtimit të vendimeve të Plenumit të Gjykatës së Kasacionit.

Të rifillojë menjëherë ekzekutimi i vendimeve civile të pezulluara me urdhërat e përsëritura.

Ky vendim është i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

U shpall sot më datën 21.9.1995

Votuan kundër këtij vendimi: Zija Vuci e Metush Saraçi.

MENDIMI I PAKICËS

Me vendimin nr.12, datë 21.9.1995, të Gjykatës Kushtetuese nuk jam dakord për këto arsye:

Këshilli i Ministrave ka kërkuar të deklarohet antiligjore dhe antikushtetuese veprimtaria e Kryetarit të Gjykatës së Kasacionit që ka të bëjë me fazën e ekzekutimit të vendimeve civile të formës së prerë.

Është e vërtetë se ky i fundit ka urdhëruar në mënyrë të përsëritur dhe në mjaft raste pezullimin më tepër se dy muaj të ekzekutimit të këtyre vendimeve, por këto akte të tij nuk kanë pasë karakter normativ, dmth, zbatimi i tyre nuk ka qenë i detyrueshëm për zyrat e përbarimit. Kjo për arsye se urdhërat për pezullimin, tej afatit dy mujor të këtyre titujve ekzekutivë janë në kundërshtim me dispozitat urdhëruese të Kodit të Procedurës Civile. Si të tilla ato janë akte absolutisht të pavlefshme dhe për rrjedhojë nuk i nënshtrohen kontrollit konstitucional. Pra, nuk lind nevoja që këto të deklarohen antikushtetuese ose antiligjore dhe për këtë shkak të shfuqizohen nga Gjykata Kushtetuese.

Fakti që pjesa më e madhe e këtyre urdhërave janë zbatuar nga përbaruesit gjyqësorë, kjo nuk do të thotë që duhet pranuar se çështja hyn në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.

Për më tepër, siç del edhe nga kërkesa e Këshillit të Ministrave, disa nga këto urdhëra, me ndërhyrjen e Ministrisë së Drejtësisë nuk janë përfillur nga zyrat e përbarimit, të cilat kanë rifilluar dhe përfunduar ekzekutimin për disa vendime gjyqësore.

Nga ana tjetër edhe po t'i referohemi dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, rezulton se pala e dëmtuar nga këto veprime të Kryetarit të Gjykatës së Kasacionit, i ka pasë të gjitha mundësitë që për mbrojtjen e të drejtave të saj t'i drejtohej gjykatës së zakonshme, duke ngritur padinë e kundërshtimit të veprimeve përbarimore.

Jo vetëm kaq, por edhe sikur në këtë çështje të jepej një vendim i disfavorshëm për të, ajo përsëri i kishte mundësitë të ushtronte të drejtën e ankimit dhe të investonte si Gjykatën e Apelit ashtu edhe Gjykatën e Kasacionit për shqyrtimin e saj. Bile ajo mund të mbrohej duke bërë edhe propozim që të ushtrohej kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, mjet të cilin e disponon, përveç Kryetarit të Gjykatës së Kasacionit edhe Prokurori i Përgjithshëm.

Pra, në raste të tilla ndodh pak a shumë e njëjta gjë, siç ndodh edhe në rastet kur kolegjet e Gjykatës së Kasacionit ose Plenumi i saj (dhe jo Gjykata Kushtetuese), janë të autorizuar me ligj të kontrollojnë ligjshmërisë dhe të rrëzojnë një kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, e cila është ngritur pas një viti nga data e ekzekutimit të një vendimi civil të formës së prerë.

Në bazë të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 19.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, janë përcaktuar në mënyrë taksative kompetencat e Gjykatës Kushtetuese.

Duke analizuar përmbajtjen e këtij ligji dhe duke u përqëndruar vetëm në trajtimin e çështjeve që ngrihen në kërkesën e Këshillit të Ministrave, pra pa dalë jashtë objektit të kësaj kërkesë, unë arrij në këtë përfundim :

Që, edhe sikur nga këto veprime të parregullta të Kryetarit të Gjykatës së Kasacionit, të vërtetuara në fazën e ekzekutimit të vendimeve civile të formës së prerë, të jenë shkelur të drejtat themelore të qytetarëve, përsëri Gjykata Kushtetuese nuk duhej ta zgjidhte këtë çështje në themel. Ajo mund të investohej dhe ta zgjidhte atë përfundimisht, vetëm pasi të ishin konsumuar të gjitha mjetet e zakonshme që disponojnë organet e pushtetit gjyqësor dhe vetëm kur këto organe do të dilnin me

vendime ose akte të tjera që vijnë në kundërshtim me ligjin ose dispozitat kryesore kushtetuese.

Për mendimin tim, nuk ka ndonjë pengesë ligjore, që edhe pa këtë vendim që mori Gjykata Kushtetuese, të vihet përpara përgjegjësisë civile ose penale cilido që me sjelljet e qëndrimet e tij ka krijuar çrregullime në veprimtarinë normale të organeve të drejtësisë ose që i ka shkaktuar një dëm të rëndësishëm interesave të qytetarëve, duke përfshirë këtu edhe shkeljen e të drejtave të tyre themelore.

Në këto rrethana, unë mendoj që çështja objekt gjykimi të nxirret jashtë juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese.

A N Ë T A R
Zija Vuci